



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



RREGULLORE PËR PROVIZIONIMIN E LLOGARIVE TË ARKËTUESHME TË “TREPÇA” SH.A

Mitrovicë, më 25.11.2022



Me qëllim të implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Ligjit për tatim në të ardhura të korporatave (Ligji Nr.03/L- 162), Ligjit për Shoqëritë Tregtare (Ligji Nr 02/L-123), Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087) , Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike (Ligji Nr. 03/L-048) , Ligji i Trepça SH.A (Ligji Nr 05/L -120) dhe Statutit të Trepça SHA , Bordi Mbikëqyrës i “Trepça” Sh.A. në mbledhjen e mbajtur më 25.11.2022, aprovon këtë:

Rregullore e përgjithshme për provizionimin e llogarive të arkëtueshme të “Trepça” Sh.A

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e procedimit, përlllogaritjes dhe regjistrimit të provizionimit të llogarive të arkëtueshme.

Neni 2

Departamenti financiar në kuadër të ndërmarrjes “Trepça” Sh.A. është përgjegjës për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) si dhe të gjitha procedurat dhe politikat kontabël të aprovuara nga ndërmarrja “Trepça” Sh.A..

Përmes kësaj Rregullore, Ndërmarrja “Trepça” Sh.A do të ketë një politikë të shlyerjes në lidhje me kalkulimin e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme dhe një kontrollë më të mirë ndaj kërkesave.

Ndërmarrja “Trepça” Sh.A., do të bëjë analiza të rregullta të vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme. Kjo do t’i ndihmoj menaxhmentit që të përmirësoj arkëtimet dhe barazimet me blerësit dhe të bëjë vlerësime të sakta për provizione të borxheve të këqija.



I. Shpenzimet për borxhet e këqija

Neni 3

Regjistrimet akruale bëhen për të pasur mundësi në parashikimin e të hyrave nga shitjet, lejimet për shitje si dhe zbritjet që i takojnë shitjeve të tanishme të konsumuara që nga data e raporteve financiare.

Neni 4

Harmonizimi i duhur mund të arrihet vetëm nëse shpenzimi për borxhet e këqija është i regjistruar në periodën e njëjtë fiskale me të hyrat ndaj të cilave kanë lidhshmëri. Nëse ky shpenzim mund të njihet me saktësi atëherë do të bëhet provizionimi.

Neni 5

Provizionimi do të bëhet në ngarkesë të shpenzimeve të provizionimit të llogarive të arkëtueshme për borxhet e këqija dhe lejimeve për llogaritë e arkëtueshme.

Debi: Shpenzimet e provizionimit të LL/A

Kredi: Lejimet për LL/A

Neni 6

Llogaritë e arkëtueshme dhe pagesat do të analizohen çdo muaj nga Departamenti i financave, për të filluar veprimet e nevojshme për mbledhjen e borxheve, do të raportohen çdo tremuaj derisa në baza vjetore kalkulohet provizionimi për llogaritë e arkëtueshme të vlerësuara si të dyshimta dhe si borxhe të këqija. Vlera e llogarive të arkëtueshme në bilancin e gjendjes do të tregohet pas heqjes së lejimeve për llogari të arkëtueshme.



II. Borxhi i keq

Neni 7

Një borxh i keq do të konsiderohet shpenzim nëse:

- Shuma që korrespondon me borxhin, më përpara është përfshirë në të hyra;
- Kanë kaluar së paku 6 muaj nga afati i pagesës;
- Nuk ka kontest mbi vlefshmërinë juridike të borxhit;
- Borxhi është regjistruar në libra si i padobishëm për qëllime kontabiliteti; dhe
- Ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin,
- Përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimizuar mbledhjen e borxhit, sikurse janë:
- Barazimi i çdo borxhi të pakontestueshëm kundrejt borxhit të keq,
- Korrespondenca dhe kontaktet në përpjekje për mbledhjen e borxhit,
- Veprimi juridik ka qenë i pasuksesshëm, apo është konsideruar si joekonomik për
- arësye të dokumentuara.

Neni 8

Llogaritë e arkëtueshme dhe pagesat do të rishikohen në fund të çdo viti financiar për të siguruar se borxhet e dyshimta janë kontabilizuar në mënyrë adekuate.

Neni 9

Autoritetin për shlyerjen e borxheve e tilla e ka Kryeshefi Ekzekutiv ose nën vartësit nëse autorizohen nga Kryeshefi Ekzekutiv i “Trepça” Sh.A- pas aprovimit paraprak nga Bordi Mbikëqyrës.

Neni 10

Dispozitat përfundimtare

Kjo rregullore e përgjithshme për provizionimin e llogarive të arkëtueshme të Trepça Sh.A., hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe fillon të aplikohet prej ditës së publikimit në web-faqen zyrtare.

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A


Dr.Sc. Bahri Hyseni

